



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRA	
01 Nr. / Nr.	258/20
Nr. i Eq. / Nr. sht.	-1-
Data / Datum	07. 12. 2020
VUSHTRRI - VUČITRA	



Kuvendi i Komunës - Vushtri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 41, paragrafi 2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës, nenit 11 të Rregullores (KKV) Nr. 01/2018 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **07 dhjetor 2020**, merr këtë:

**VENDIM  
PËR PËRKRAHJE FINANCIARE TË FAMILJEVE TË PREKURA NGA PANDEMIA  
COVID-19**

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahja financiare për familjet e prekura nga pandemia Covid-19 të cilat janë përfituese të asistencës sociale, familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale në shumë financiare prej njëqind e pesëdhjetë euro (150 €) deri në treqind euro (300 €), përkrahën familjet që nuk kanë të ardhura, ato me të ardhura më pak se treqind e pesëdhjetë euro (350 €) në muaj në Komunën e Vushtrrisë.
2. Përfituesit e këtyre mjeteve financiare, mund të aplikojnë përmes formave online, apo në formë fizike në Komunën e Vushtrrisë nga data 05 janar 2021, konform dispozitave ligjore të përcaktuara me Rregulloren (KKV) Nr. 01/2018 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë.
3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të sigurohen nga kategoria e subvencioneve në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
5. Ky vendim do të ketë efekt retroaktiv nga muaji mars 2020, dhe fillon të prodhojë efekt juridik nga data 05 janar 2021.
6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

  
Nasuf Aliu  
Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUŠTRIN	
01 Nr. / Br	259/20
Nr. i fq. / Br. sht	- 1 -
Data / Datum	07.12.2020
VUSHTRIN - VUŠTRIN	



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 41, paragrafi 2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **07 dhjetor 2020**, merr këtë:

### VENDIM PËR THEMELIM TË KOMISIONIT

- Me këtë vendim themelohet komisioni kuvendar për vlerësimin e gjendjes dhe shqyrtimin e aplikacioneve për familjet e prekura nga pandemia covid-19, të cilat janë përfituese të asistencës sociale, familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale, familjet që nuk kanë të ardhura, ato me të ardhura më pak se treqind e pesëdhjetë euro (350 €) në muaj në Komunën e Vushtrrisë.
- Përbërja e komisionit të lartë cekur është si në vijim:
  - 2.1 Basri Menxhiqi, anëtar i komisionit;
  - 2.2 Ismet Hajrizi, anëtar i komisionit;
  - 2.3 Gresa Muli, anëtare e komisionit;
  - 2.4 Nezir Klinaku, anëtar i komisionit;
  - 2.5 Abdullah Vojvoda, anëtar i komisionit.
- Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të ketë për detyrë t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha aplikacionet, të vlerësojë gjendjen e familjeve që janë të prekura me pandeminë covid-19 dhe në bashkëpunim me komisionin për shëndetësi do të vendos për përfituesit e subvencioneve.
- Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: komisioni i cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit